

UDHËZUES PUPIL MESSENGER



UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E PUPIL MESSENGERS

Në këtë dokument po ju japim një ndihmë për përdorimin e Messengers.

Të dhëna të rëndësishme në lidhje me PUPIL Messenger për Schulen Kirchberg:

CODE (KODI): **KIBA**


Benutzername (Emri i përdoruesit):

Adresa juaj e emailit*

Passwort (Fjalëkalimi): **Fjalëkalimi juaj****

*Ju lutemi, përdorni adresën e emailit që i keni dhënë shkollës. Sepse PUPIL Messenger nuk do të funksionojë me një adresë tjetër emaili. Nëse keni një adresë të re emaili, duhet të njoftoni administratën e shkollës për ndryshimin.

** Fjalëkalimin tuaj duhet ta krijoni kur të hyni për herë të parë, duke i dërguar vetes një fjalëkalim të ri.



UDHËZUES PUPIL MESSENGER

Hapi 1: Shkarkoni aplikacionin

Shkarkojeni PUPIL Messenger në App Store ose në Play Store. Tek Store përkatës kërkoni „PUPIL” ose përdorni kodin QR në këtë faqe.

Hapi 2: Rivendosni fjalëkalimin

Fjalëkalimi duhet të rivendoset vetëm nëse nuk e keni më fjalëkalimin që keni marrë.

Për ta bërë këtë, tek KODI vendosni kodin „KIBA” dhe si emër përdoruesi vendosni adresën tuaj të emailit. Pastaj klikoni në Login (hyrja) për të shfaqur funksionin "Passwort vergessen" (Kam harruar fjalëkalimin).

> Tani klikoni „Passwort vergessen” (Kam harruar fjalëkalimin).

> Vendosni përsëri adresën tuaj të emailit dhe klikoni në „Passwort zurücksetzen” (Rivendosni fjalëkalimin)

> Një email do të dërgohet në adresën e specifikuar. Në këtë email do të gjeni një fjalëkalim të përkohshëm 8-shifror.

Hapi 3: Login (Hyrja)

Kthehuni te Messenger dhe klikoni në „Zurück zum Login”. (Kthehu tek hyrja). Tani, tek „Passwort” (Fjalëkalimi) vendosni fjalëkalimin që keni marrë dhe hyni duke klikuar në „Login” (hyrja).

Hapi 4: Ndryshoni fjalëkalimin

Për të ndryshuar fjalëkalimin tuaj, klikoni në „Einstellungen” (Cilësimet) dhe pastaj në „Passwort ändern” (Ndryshoni fjalëkalimin). Këtu vendosni fjalëkalimin që keni marrë dhe konfirmoni ndryshimin e fjalëkalimit duke vendosur një fjalëkalim të ri dy herë dhe duke klikuar në „Passwort ändern” (Ndrysho fjalëkalimin).

PËR TELEFONAT
IPHONE



Laden im
App Store


PËR TELEFONAT ME
ANDROID



JETZT BEI
Google Play

Këtu mund të zgjidhni midis Chats (bashkëbisedimit individual), Gruppenchats (bashkëbisedimit në grup) dhe Broadcasts (transmetimeve).

Këtu krijoni një bashkëbisedim të ri.



Pika e kuqe pranë Chat & Gruppen (bashkëbisedime dhe grupe) ju tregon se ka mesazhe të palexuara. Numri brenda rrethit tregon sa mesazhe janë të palexuara.

Për të hequr një bashkëbisedim, shtypni Chat-in (bashkëbisedimin) përkatës dhe mbajeni ashtu për një kohë të gjatë. Do t'ju shfaqen opsionet përkatëse (p.sh. Chat verlassen (dilni nga bashkëbisedimi)).

Nga këtu, shkoni në Elternportal (portali i prindërve) dhe në funksionet e ndryshme që janë në dispozicionin tuaj

Tek Einstellungen (cilësimet) mund të ndryshoni fjalëkalimin tuaj dhe të të dilni.



Këtu mund të gjeni informacione rreth shkollës

Këtu mund të njoftoni shkollën tuaj për mungesat e fëmijës suaj.

Ju lutemi, vini re:

Jo të gjitha shkollat i përdorin të gjitha funksionet e PUPIL Messenger. Shkolla do t'ju informojë në kohën e duhur për funksionet e reja në Messenger.